



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Njoftim publik **nr. 05 – 015/02 – 98789/20**

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës duke u bazuar në Neni 2, 7 dhe 8 të Ligjit Nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave, Vendimin 01 nr. 031 -223419 të Kuvendit të Komunës së Prishtinës dhe Neni 6, pika 1.2., pika 1.2.1., pika 1.2.1.2. dhe pika 1.2.2., Neni 7, pika 1, pika 2 dhe pika 3 të Udhëzimit Administrativ Nr. 17/2019 të MMPH – së, ka inicuar dhe proceduar emërtimin e rrugës së re, rruga me kod të veçantë (kodi 10777) dhe ka bërë propozimin për emërtim të kësaj rruge në ZK. Zllatar


Agjencia Kadastrale e Kosovës ka digjitalizuar (si rrugë të re) segmentin e rrugës që shtrihet në këtë hapësirë, ndërsa Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës duke u bazuar në aktet e lartëshënuara jep propozimin për emrin e rrugës.

Emri i propozuar: **“PRINCESHA ARGJIRO”** – poemë për fëmijë e shkrimtarit Ismail Kadare.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data 24.06.2019 deri më 08.07.2020, në E-mail adresën: urbanizmi@rks-gov.net

Në bazë të *Udhëzimit Administrativ Nr. 17/2019 të MMPH –së, për krijimin dhe administrimin e listës alfabetike për emërtime, listës rezervë dhe vendosjen e tyre nga regjistri komunal*, neni 7, paragrafët 1, 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës.

Në të gjitha komentet tuaja duhet të përshkruhet numri i njoftimit publik të shënuar më lartë.



Nënshkrimi i Zyrtarit: _____